

**MBI NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË DHE NË TREGUN VALUTOR
GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2024**

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2024

1.1. Operacione të tregut të hapur dhe faktorët që kanë ndikuar në mungesën e likuiditetit në sistemin bankar

Tabelë 1: Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në miliardë lekë¹.) Burimi: Banka e Shqipërisë.

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO >1javë <3muaj	REPO Njëditore	Totali i likuiditetit të injektuar
4-Jan-24		16.84			31.90
11-Jan-24		8.41			23.47
18-Jan-24		3.88			18.94
25-Jan-24		13.29			20.25
01-Shk-24		7.84			14.80
08-Shk-24		9.09			16.05
15-Shk-24		12.59			19.55
22-Shk-24		22.11			29.07
29-Shk-24		18.24			20.90
07-Mar-24		14.80			17.46
15-Mar-24		19.72			22.38
21-Mar-24		26.76			29.42
28-Mar-24		31.50			31.50

Në tremujorin e parë të vitit 2024, ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë konsistuan në operacionet e tregut të hapur për injektim likuiditeti.

Injektimi mesatar ditor nëpërmjet operacioneve injektuese të likuiditetit me maturim 1-13 javë ra në mesatarisht 22.70 mld lekë, kundrejt përkatësisht 47.70 miliardë lekë dhe 54.20 miliardë lekë në tremujorët e mëparshëm. Sikurse zakonisht, akumulimi i likuiditetit në llogarinë e MF gjatë vitit dhe përqendrimi i shpenzimeve në periudhën dhjetor-janar është faktori kryesor i volatilitetit të mungesës së likuiditetit në sistemin bankar. Mungesa e likuiditetit ra gradualisht nga 65.60 miliardë

¹ Shifrat janë në vlerë likuiditeti.

lekë në fillim të muajit shtator, në 41.10 mld lekë në fillim të vitit 2024 dhe 10.80 mld lekë në fund të muajit janar. Rënia e shpejtë e mungesës së likuiditetit bëri që në javën e tretë të muajit janar, injektimet javore të bien në nivelin e 3.90 miliardë lekëve, ndërkohë që injektimet e gjata qëndruan në nivelin 15.10 mld lekë. Depozitat e bankave të nivelit të dytë pranë BSH-së, në formën e likuiditetit të patregtueshëm mbërritën në pothuajse 24 mld lekë, duke treguar praktikisht për kalim të sistemit bankar në tepriçë likuiditeti.



Pas rritjes së marrëveshjeve SWAP me 25 mld lekë në ditët e para të vitit dhe shpenzimin e likuiditetit, gjendja e likuiditetit në llogaritë e qeverisë nisi të bjerë në nivele minimale, duke nisur të rritet vetëm në fund të periudhës me një vlerë rreth 26.60 mld lekë. Në të njëjtën periudhë, ndërhyrjet në tregun valutor rritën nivelin e likuiditetit me 4.60 mld lekë. Paraja në qarkullim regjistroi rënie me 2.70 mld lekë, ndërkohë që veprimet me portofolin rritën nivelin e likuiditetit me 0.50 mld lekë, duke pasur një efekt total në rënien e mungesës me 7.8 mld lekë.

Në kushtet e rritjes së likuiditetit të bankave, përpjekjet operacionale janë fokusuar drejt nxitjes së bankave në tregtimin e likuiditetit të tepërt, ndërkohë që është bërë e mundur që tregtimi të rritet në nivelet maksimale të viteve të fundit. Sikurse ka ndodhur edhe në periudhat e mëparshme, rënia graduale e likuiditetit të vetë bankave (oferta) ka sjellë si rezultat edhe uljen e tregimit në tregun ndërbankar. Pavarësisht likuiditetit të tepërt dhe të patregtueshëm, norma e tregimit në tregun ndërbankar ka pësuar një shmangie minimale nga norma bazë, ku komunikimi më i shpeshtë me bankat ka luajtur një rol vendimtar.

Përqendrimi i mungesës në një bankë dhe ruajtja e kufizimit për pjesëmarrje maksimale 80%, ka bërë që, raporti i mbulimit të ankandëve të injektimit javor të jetë nën 1 pothuajse përgjatë gjithë periudhës raportuese, ndërkohë që norma mesatare e pranuar ka rënë nën normën bazë për disa javë. Në fund të tremujorit, me rritjen e mungesës, raporti i mbulimit është rritur afër 1-shit dhe norma mesatare është rritur me 2 pikë përqindje mbi normën bazë.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudhën 2021-2024 (me vlerë nominale)

Burimi: Banka e Shqipërisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.2 Përdorimi i operacioneve lehtësuese të përhershme

Përdorimi i instrumentit të depozitës është rritur gjatë periudhës në fjalë me mesatarisht 18.90 mld lekë kundrejt përkatësisht 4.70 miliardë lekë dhe 0.50 miliardë lekë në periudhat e mëparshme.

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të parë të vitit 2024

Numri i bankave që kanë përdorur depozitën është rritur për shkak të rritjes së likuiditetit në shumë prej bankave të sistemit.


Kredia është përdorur në 13 raste, kundrejt përkatësisht 14 dhe 11 rasteve të regjistruara në tremujorët e mëparshëm.

1.3 Operacionet strukturore për menaxhimin e likuiditetit të sistemit bankar dhe portofolin e Bankës së Shqipërisë

Gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2024, Banka e Shqipërisë ka vijuar të tentojë rritjen e portofolit nëpërmjet ankandeve të blerjes së letrave me vlerë. Sikurse përgjatë gjithë vitit 2023, pjesëmarrja e bankave ka qenë mjaft e ulët, duke bërë që në 9 ankande, portofoli të rritet me vetëm 2.45 mld lekë, ndërkohë që janë maturuar nga ulja e pjesëmarrjes në ankandet primare 2 mld lekë letra me vlerë.

Vlera e portofolit të bonove të thesarit të Bankës së Shqipërisë është 70.00 miliardë lekë, pranë niveleve maksimale të vërejtura. Në terma relativë kundrejt borxhit publik të emetuar në monedhën kombëtare, madhësia e portofolit qëndroi nën nivelin 10% krahasuar me 25% që shënonte kjo vlerë në fillim të viteve 2000.

Grafik 3: Portofoli i Bankës së Shqipërisë (mld lekë)



1.4 Përdorimi i operacioneve rregulluese

Gjatë periudhës, nuk janë zhvilluar operacione rregulluese.


2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2024

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2024, sikurse lajmëruar edhe në muajin dhjetor 2023, me objektiv rritjen e rezervës valutore, Banka e Shqipërisë zhvilloi tre ankande për blerjen e valutës, ku vetëm njëri prej tyre ka qenë me opsionin SPOT.

Në ankandet e zhvilluara janë blerë 32.60 milionë euro. Në ankandin e fundit të zhvilluar në muajin mars u regjistrua një pjesëmarrje mjaft e ulët. Në këtë ankand u blenë 5.8 milionë euro, ndërkohë që shuma e blerë në dy ankandet e tjera mbetet rreth mesatares së vitit 2023.

Grafik 4: Ankandet e valutës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kalendari i ndërhyrjeve - Viti 2024

	Data	Shuma Raundi I (në euro)	
1	16/02/2024	5-10 mln	1 mo Fw
2	15/03/2024	5-10 mln	
3	26/03/2024	5-10 mln	1 mo Fw
4	19/04/2024	5-10 mln	
5	30/04/2024	5-10 mln	1 mo Fw
6	17/05/2024	5-10 mln	

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të parë të vitit 2024

7	24/05/2024	5-10 mln	1 mo Fw
8	06/06/2024	5-10 mln	
9	13/06/2024	5-10 mln	1 mo Fw
10	21/06/2024	5-10 mln	
11	12/07/2024	5-10 mln	
12	19/07/2024	5-10 mln	
13	26/07/2024	5-10 mln	
14	09/08/2024	5-10 mln	
15	16/08/2024	5-10 mln	1 mo Fw
16	17/09/2024	5-10 mln	1 mo Fw
17	18/10/2024	5-10 mln	1 mo Fw
18	20/11/2024	5-10 mln	1 mo Fw
19	05/12/2024	5-10 mln	
20	20/12/2024	5-10 mln	1 mo Fw

** Në rastet kur ankandi bie në ditë pushimi, ankandi do të organizohet në ditën pasardhëse të punës.*

Gjatë vitit 2024, me objektiv rritjen e rezervës valutore, Banka e Shqipërisë synon të blejë përmes ankandeve 250-330 milionë euro**2.2 Veprime me institucione të tjera**

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, MF ka rritur shumën e marrëveshjeve SWAP me 25 mld lekë, ndërkohë që i ka shitur Bankës së Shqipërisë 60 milionë euro me kursin 102.60 lekë. Kjo shitje është realizuar me qëllim financimin e shpenzimeve të rritura për llogari të vitit 2023. Duke parë rritjen e likuiditetit në llogaritë e qeverisë në fund të tremujorit dhe në vijim, MF pritet të maturojë të gjitha marrëveshjet SWAP me Bankën e Shqipërisë në tremujorin e dytë.

Ndër veprimet e tjera, vlen të përmendet blerja e 2.2 milionë eurove nga MF në kuadër të fondeve të programit IPA.